

Fisnik Muça, PhD ¹
Nasuf Strikçani ²

UDC:
341.231.14:28

**ROLI DHE RËNDËSIA E ORGANIZATËS SË BASHKËPUNIMIT
ISLAMIK NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË
NJERIUT**

**УЛОГАТА И ВАЖНОСТА НА ОРГАНИЗАЦИЈАТА НА
ИСЛАМСКА СОРАБОТКА ВО ЗАШТИТАТА НА
ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА И СЛОБОДИ**

**THE ROLE AND IMPORTANCE OF THE ORGANISATION OF
ISLAMIC COOPERATION IN THE PROTECTION OF HUMAN
RIGHTS AND FREEDOMS**

Abstract

International organizations of different characters have a particular importance on the scene of international relations. After World War II, the main purpose of states is the cooperation and achieving multilateral agreements, being integrated in this way in international and regional organizations. Through this research work we aim to highlight the role and importance of the Organization for Islamic Cooperation in the protection of the human rights and freedoms of member countries, and what impact this organization has on international peace and security. Making a description of the establishment of this organization, goals and objectives which are defined by the Cairo Declaration on Human Rights in Islam, we understand what is the role of this organization in the international arena, with particular emphasis on the majority Muslim countries. To accomplish this research, materials from

¹ Doktor i Shkencave Politike, Ministria e Drejtësisë, fisnik.muca@hotmail.com

² Magjistrant në Fakultetin e Filozofisë - Dega Sociologji pranë Universitetit të Tetovës, nasuf.strikciani@hotmail.com

the official website of the Organization and different news from electronic portals were used, as well as the authors' opinions about this organization: protects or fails to protect human rights and freedoms. Human rights and freedoms according to the concept of this organization, although not consistent with human rights and freedoms as foreseen by the UN Charter, again we can conclude that the importance of it, based on principles that have been associated with religious ones, is present in the region and the world.

Keyword: human rights, international organization, cooperation, Islamic

Hyrje

Gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar, si rezultat i zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe proceseve të integritimit ekonomik, shtetet e ndryshme u ndërlidhën mes vete dhe u krijua një ndërvarshmëri mes tyre si kurrë më parë. Shtetet, si aktorë të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, bashkëpunojnë mes veti nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe, disapalëshe dhe shumëpalëshe. Marrëveshjet shumëpalëshe janë rezultat i negociatave dhe diskutimeve mes shteteve në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale. Organizatat ndërkombëtare, janë aktorë mjaft të rëndësishëm në ngjarjet kritike të cilat zhvillohen në politikën ndërkombëtare, nëpërmjet fuqisë së ndërmjetësimit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të cilat paraqiten mes shteteve anëtare dhe joanëtare, në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vendosjen e agjendave ndërkombëtare për bashkëpunim, si dhe sigurimin e hapësirës e nevojshme në marrëdhëniet ndërkombëtare për ndërmarrjen e iniciativave politike duke vepruar në këtë mënyrë si katalizatorë për formimin e koalicioneve dhe anëtarësimeve të reja. Organizatat ndërkombëtare ofrojnë një ndihmë mjaft të rëndësishme në menaxhimin e fushave të ndryshme, të cilat paraqesin shqetësim ndërkombëtar, duke nisur nga politikat ndërkombëtare të shëndetësisë, politikat tregtare dhe ekonomike, politikat monetare dhe fiskale, politikat e sigurisë dhe të paqes, e kështu me radhë. Organizata ndërkombëtare mund të definohet si një marrëveshje institucionale mes shteteve anëtare në sistemin ndërkombëtar të qeverisjes, me qëllim që të arrihen disa qëllime dhe objektiva të caktuara të cilat do të jenë në pajtueshmëri me kushtet e sistemit, gjë që pason me reflektim të attributeve të anëtarëve të saj, aspiratat dhe çështjet me të cilat do të merren, duke nxjerrë rregulla dhe parime të cilat duhet të respektohen nga të gjithë

anëtarët, obligime dhe detyrime të cilat duhet të realizohen për një periudhë të caktuar kohore. Organizatat ndërkombëtare janë themeluar për të përfshirë fusha të ndryshme të sistemit ndërkombëtare dhe atë: politike (OKB-ja), ushtarake dhe të sigurisë (NATO-ja), ekonomike, tregtare dhe financiare (OBT-ja, FMN-ja, Banka Botërore), si dhe religjioze (OBI-ja). Të gjitha organizatat ndërkombëtare të fushave të ndryshme luajnë rol të rëndësishëm në aspekt të rregullave dhe parimeve ndërkombëtare, por në këtë punim hulumtues do të fokusohemi në organizatat ndërkombëtare të karakterit religjioz, me theks të veçantë në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik, për të nxjerrë në pah se çfarë roli dhe rëndësie ka kjo organizatë në aspekt të paqes dhe sigurisë të rajonit dhe atë ndërkombëtare, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në realizimin e interesave të ndryshme të shteteve anëtare, si dhe në promovimin e vlerave kulturore dhe shkencore.

1. Historiku dhe qëllimet e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik(OBI)

Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OBI), është një organizatë ndërkombëtare e karakterit religjioz, që është themeluar në vitin 1969, që deri më nëntor të vitit 2017 numëron gjithsej 57 shtete anëtare, me një popullatë të përgjithshme prej 1.6 miliardë banorë, sipas regjistrimeve të vitit 2008. Sipas numrit të shteteve anëtare, OBI është organizata e dytë më e madhe ndërkombëtare pas OKB-së, që është e shtrirë në katër kontinente. *“Organizata është zëri kolektiv i botës muslimane. Roli i kësaj organizate është të ruajë dhe mbrojë interesat e botës muslimane, në frymën e nxitjes dhe promovimit të paqes dhe harmonisë ndërkombëtare mes njerëzve të ndryshëm të botës.”*³ Qysh prej shekullit të 19-të, një pjesë e muslimanëve kishin aspirata që të formojnë bashkësinë muslimane në nivel botëror, me qëllim që të realizonin interesat e përbashkëta politike, ekonomike dhe sociale. Rënia e Perandorisë Osmane, perandoria e fundit islame dhe kalifati që depërtoi edhe në Evropë, si dhe pas Luftës së Parë Botërore, u krijua një vakum në aspekt të institucioneve panislamike. Edhe pse nuk ishte e vetmja arsye, konflikti në Jerusalem rreth xhamisë El-Aksa, llogaritet si njëri ndër katalizatorët për themelimin e Organizatës të Konferencës Islamike (OKI).⁴ Pas samitit historik që u realizua mes liderëve të vendeve muslimane në Rabat të

³ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=52&p_ref=26&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

⁴ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=52&p_ref=26&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

Mbretërisë së Marokut, me datë 25 Shtator 1969 (12 Rexheb 1389 sipas kalendarit lunar), u themelua OKI, organizata e vendeve muslimane që do të merrej me zgjidhjen e konflikteve dhe marrëveshjeve të cilat sot e kësaj dite mbeten aktuale në skenën e Lindjes së Mesme. Shtetet anëtare në OBI-së, si rezultat i Konferencës së Mbretërve të mbajtur në Marok dhe Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare të mbajtur në Xhide të Arabisë Saudite mes datave 29 Shkurt deri më 4 Mars 1972 (14 deri më 18 Muharem të vitit 1392 sipas kalendarit lunar), miratuan njëzëri Kartën e Organizatës të Bashkëpunimit Islamik (në atë kohë Organizata e Konferencës Islamike).⁵ Shtetet anëtare të kësaj organizate, duke u bazuar në Kartën e saj, janë dakorduar që do të udhëhiqen nga vlerat fisnike islame për bashkim dhe vëllazërim, duke afirmuar dhe konsoliduar solidaritetin mes shteteve anëtare, me ç’rast do të mbrojnë dhe sigurojnë interesat e përbashkëta në arenën ndërkombëtare. Në bazë të Kartës së OBI-së, shtetet anëtare të saj synojnë të ruajnë vlerat sociale dhe ekonomike në këndvështrimin islam; të promovojnë solidaritetet mes vendeve anëtare, të rrisin bashkëpunimin në fushat sociale, ekonomike, kulturore, shkencore dhe politike; të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare; si dhe të nxisin një edukim përparimtar, me theks të veçantë në shkencë dhe teknologji.⁶ OBI-ja ka delegatë të përhershëm në Kombet e Bashkuara dhe në Bashkimin Evropian, gjë që të jep të kuptosh që kjo organizatë ka një bashkëpunim me dy organizatat të cilat po ashtu synojnë paqen dhe sigurinë në nivel rajonal apo ndërkombëtar.

Figura nr.1: Flamuri i mëparshëm i OBI-së dhe stema aktuale e kësaj organizate



Flamuri i mëparshëm OBI-së



Stema e OBI-së

⁵ Charter of the Organisation of Islamic Cooperation, gjetur me datë 3 Nëntor 2017 në https://www.oic-oci.org/page/?p_id=53&p_ref=27&lan=en

⁶ Charter of the Organisation of Islamic Cooperation.

Në figurën nr. 1 në anën e djathtë është paraqitur stema apo flamuri aktual i OBI-së me dy ngjyra dhe atë: ngjyrën e bardhë dhe të gjelbër, kurse tri elementet e përfshira janë: gjysmëhëna, globi dhe Qabja (Shtëpia e Zotit në Meke të Arabisë Saudite sipas fesë islame) në qendër të globit. Në të majtë të figurës nr. 1 është flamuri i mëparshëm i OBI-së, i cili është zëvendësuar në vitin 2011. Flamuri i mëparshëm paraqitej me një sfond të gjelbër, gjysmëhënën e kuqe të përmbysur dhe të mbështjellë me një rreth të bardhë, në brendësi të së cilit mund të lexohen fjalët Allahu Ekber (Zoti është më i Madhi), të shkruar me kaligrafi arabe.⁷ Gjuhët zyrtare të cilat përdoren në OBI janë: gjuha arabe, angleze dhe franceze. OBI-ja ka zyrat e saj në: Nju Jork, Gjenevë, Bruksel, Irak, Kabul dhe Indonezi.

Më 5 gusht të vitit 1990, 45 ministrat e jashtëm të OBI-së, pranuan Deklaratën e Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam, që do të ishte një udhëzues për vendet anëtare në kuptim të të drejtave të njeriut, duke i përputhur dhe për të qenë në pajtueshmëri me Sheriatin apo Ligjin e Zotit. *“Duke besuar që të drejtat dhe liritë themelore sipas Islamit janë pjesë përbërëse e religjionit Islam dhe që asnjëri nuk ka të drejtën që si një parim ti shfuqizojë, qoftë tërësisht apo pjesërisht, apo ti shkelë dhe ti injorojë ato, duke marrë parasysh që kur janë edhe urdhra hyjnorë të detyrueshëm, të cilat janë të shkruar në Librat e shpallur të Allahut dhe janë të dërguara nëpërmjet profetit të Tij të fundit, që do të ishte një kompletim i mesazheve të mëparshme hyjnore dhe që ruajtja dhe këtyre të drejtave themelore është një akt adhurimi, kurse shkelja apo neglizhimi i tyre është një mëkat, dhe që ruajtja e këtyre të drejtave dhe lirive themelore është një përgjegjësi individuale e çdo personi dhe një përgjegjësi kolektive e tërë Bashkësisë.”*⁸ Nëpërmjet kësaj deklaratë, duke u bazuar në dy burime dhe atë: Librin e Shenjtë dhe traditën profetike; vendet pjesëmarrëse janë dakorduar që të respektojnë dhe ruajnë të drejtat dhe liritë e njeriut, duke i kategorizuar ato në nivelin e përgjegjësive fetare dhe shoqërore. Pra, duke nënshkruar këtë deklaratë, OBI zgjodhi rrugën për të përkrahur Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe të gjitha standardet dhe parimet të cilat dalin nga e drejta ndërkombëtare, por duke inkorporuar edhe traditën fetare.

⁷ <http://www.crwflags.com/fotw/flags/int-oic.html>, gjetur me datë 12 Tetor 2017.

⁸ <http://hrlibrary.umn.edu/instree/cairodeclaration.html>, gjetur me datë 4 Nëntor 2017.

2. Shtetet anëtare, vëzhguesit dhe struktura organizative e OBI-së

OBI-ja deri në nëntor të vitit 2017 numëron gjithsej 57 shtete anëtare⁹, ku 56 prej tyre janë shtete anëtare edhe të OKB-së. Nëse marrim për bazë shtrirjen kontinentale, atëherë shohim që pjesa dërmuese e shteteve anëtare janë nga Azia (27 shtete), Afrika (27 shtete) , si dhe nga Amerika e Jugut (2 shtete) dhe Evropa (1 shtet). Shtetet anëtare të OBI-së janë: Azerbejxhani (1992), Jordania (1969), Afganistani (1969), Shqipëria (1992), Emiratet e Bashkuara Arabe (1972), Indonezia (1969), Uzbekistani (1969), Uganda (1974), Irani (1969), Pakistani (1969), Bahrejni (1972), Brunei-Daruselam (1984), Bangladeshi(1974), Republika e Beninit (1983), Burkina Faso (1974), Taxhikistani (1992), Turqia (1969), Turkmenistani (1992), Çadi (1969), Togo (1997), Tunizia (1969), Algjeria (1969), Xhibuti (1978), Arabia Saudite (1969), Senegali (1969), Sudani (1969), Siria (1972), Surinami (1996), Siera Leone (1972), Somalia (1969), Iraku(1975), Omani (1972), Gaboni (1974), Gambia (1974), Republika e Gujanës (1998), Guinea (1969), Guinea Bisao (1974), Palestina (1969), Bashkimi i Komoros (1976), Republika e Kirgizistanit (1992), Katari (1972), Kazakistani (1995), Kameruni(1974), Bregu i Fildishtë (2001), Kuvajti (1969), Libani (1969), Libia (1969), Republika Maldive (1976), Mali (1969), Malajzia (1969), Egjipti (1969), Maroku (1969), Mauritania (1969), Mozambiku (1994), Nigeri (1969), Republika Federale e Nigerisë (1986) dhe Jemeni (1969).

Sa u takon vëzhguesve të OBI-së, përfshijnë shtete, organizata dhe institucione ndërkombëtare. Shtete vëzhguese në OBI janë: Bosnja dhe Hercegovina, Republika Qendrore e Afrikës, Mbretëria e Tajlandës, Federata Ruse dhe Qiproja turke. Nga organizatat dhe institucionet religjioze islame, vëzhgues janë: Fronti Liberal Kombëtar Moro dhe Bashkimi Parlamentar i shteteve anëtare të OBI-së. Organizatat ndërkombëtare vëzhguese në OBI janë: OKB-ja, Lëvizja pa angazhim (NAM), Liga e Shteteve Arabe, Bashkimi Afrikan dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik.¹⁰ Në këtë organizatë ka edhe shtete të cilat kanë popullatë muslimane, por që nuk janë pjesë e saj të tilla si: India, Etiopia dhe Kosova.

Bashkimi Parlamentar i Shteteve Anëtare të OBI-së (BPSHA-OBI) është themeluar në vitin 1999 në Iran, me seli kryesore në Teheran. Pjesë e këtij bashkimi mund që të jenë vetëm se shtetet anëtare të

⁹ <https://www.oic-oci.org/states/?lan=en>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

¹⁰ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=179&p_ref=60&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017

OBI-së. Shtete anëtare të Bashkimit Parlamentar janë të gjitha shtetet të OBI-së, me përjashtim të: Surinamit, Bruneit dhe Uzbekistanit.¹¹ Në BPSHA-OBI janë gjithsej 22 vëzhgues duke përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe parlamente të tjera. Objektivat¹²e këtij Bashkimi janë:

- Prezantimi i rregullave sublimë të Islamit dhe shpërndarja e tyre duke theksuar karakteristikat e ndryshme dhe humanizmin e civilizimit islam;

- Rritja dhe mbështetja e parimit islam në konsultim me të gjitha shtetet anëtare të OBI-së, në përputhje me Kushtetutën dhe rrethanat e secilit shtet anëtar;

- Sigurimi i një kuadri për bashkëpunim dhe koordinim gjithëpërfshirës dhe të frytshëm midis parlamenteve të shteteve anëtare të OBI-së në forumet dhe organizatat ndërkombëtare;

- Nxitja e takimeve dhe dialogut mes parlamenteve të shteteve anëtare të OBI-së dhe zëvendësve të tyre, duke shkëmbyer përvoja parlamentare, duke diskutuar çështjet ekonomike, kulturore, sociale dhe politike në interes të vendeve anëtare të OBI-së, duke adresuar sfidat e rënda dhe përpjekjet për të imponuar dominimin kulturor, politik dhe ekonomik, si dhe rekomandimet dhe vendimet e duhura për këto çështje;

- Përforcimi i kontakteve, bashkëpunimit dhe koordinimit me organizata të tjera parlamentare, qeveritare dhe joqeveritare, me qëllim të avancimit të objektivave të përbashkëta;

- Duke u bazuar në parimin e drejtësisë, të nxisë koordinimin mes popujve të botës me qëllim të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe parimeve humanitare, duke kontribuar në këtë mënyrë në vendosjen e paqes; si dhe

- Konfirmimi që me Statutin e saj nuk do të merr autorizimin që të ndërhyjë në çështje të brendshme të vendeve anëtare dhe çfarëdo çështje cilat përputhen me Kartën e OBI-së dhe të OKB-së.


Në vitin 2007, Presidenti i atëhershëm i SHBA-së, George W. Bush, deklaroi që ai dëshiron që të vendos një të dërguar për të koalicionuar me vendet muslimane, me qëllim për të përforcuar lidhjet me Botën Islame dhe për të përmirësuar imazhin e SHBA-së. “I dërguari i yni special do të dërgojë dhe do të mësojë nga përfaqësuesit e vendeve muslimane, si dhe do të ndajë me to vlerat dhe pikëpamjet e SHBA-së. Kjo është një mundësi

¹¹ <http://www.puic.org/new/index.php/member-states/member-states>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

¹² <http://www.puic.org/new/index.php/about-puic/about-puic1/objective>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

për amerikanët që t'u demonstrojnë komuniteteve muslimane për interesat tona në respektimin e dialogut dhe miqësinë e vazhdueshme.”¹³ Gjatë këtij fjalimi, presidenti Bush e cilësoi OBI-në si një organizatë në të cilën shumë njerëz të rajonit kishin shpresa, andaj sipas mendimit të tij ishte e udhës që edhe SHBA-të të kishin përfaqësuesin e tyre, një të dërguar i cili do të ishte pjesëmarrës në takimet e vendeve anëtare. Edhe pse në vitin 2015 Arsalan Sulejman u emërua si i dërguar special në veprim i SHBA-së në OBI¹⁴, sipas të dhënave të investigimeve të emaileve, sipas Snopes.com, në vitet 2003 dhe 2004, 17 shtete anëtare të OBI-së, në Kuvendin e Përgjithshëm të OKB-së kanë votuar kundër SHBA-ve në diku 88% të kohës.¹⁵ Nga kjo mund të kuptohet që disponimi i shteteve anëtare të OBI-së gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë i orientuar drejt bashkëpunimit me SHBA-në.

Figura nr.2: Diagrami Euler për marrëdhëniet mes organizatave të ndryshme shumë nacionale dhe OBI-së



Burimi: https://en.wikipedia.org/wiki/File:OIC_Diagram-en.svg

¹³<https://web.archive.org/web/20071202125420/http://www.guardian.co.uk/world/lat-est/story/0%2C%2C-6740455%2C00.html>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

¹⁴ <https://2009-2017.state.gov/r/pa/ei/biog/237813.htm>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

¹⁵ <https://www.snopes.com/inboxer/outrage/unvote.asp>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

Në Figurën nr. 2, nëpërmjet diagramit Euler është paraqitur marrëdhënia e OBI-së me organizata të tjera shumë nacionale të tilla si: Këshilli i Bashkimit Ekonomik Arab, Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit (arab), Liga Arabe, BPASH-OBI, Bashkëpunimi Ekonomik dhe Monetar i Afrikës Perëndimore, e kështu me radhë. Në këtë diagram nuk është përfshirë Siria, si rezultat i suspendimit nga të gjitha organizatat e tjera për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe konfliktit të Luftës Civile Siriane. Siç mund të shohim nga Figura nr. 2, Shqipëria është pjesë e rrethit të OBI-së dhe njëkohësisht edhe BPASH-OBI-së.

Struktura organizative e OBI-së është e përbërë nga¹⁶:

- **Samiti Islamik** – është takimi më i gjerë, në të cilin marrin pjesë edhe mbretërit dhe udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të shteteve anëtare. Samiti Islamik merr vendimet politike kyçe dhe siguron udhëzime për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me objektivat dhe qëllimet të cilat janë të parapara me Kartën e OBI-së. Qysh nga viti 1969 deri në vitin 2016, janë mbajtur gjithsej 13 Samite të zakonshme, ku i fundit është mbajtur në datat 14 dhe 15 prill të vitit 2016 në Stamboll të Turqisë; si dhe 5 Samite të jashtëzakonshme, i fundit i mbajtur në datat 6 dhe 7 mars të vitit 2016 në Xhakartë të Indonezisë;

- **Konferenca Islamike e Ministrave të Jashtëm** – ka takime të rregullta njëherë në vit për të shqyrtuar raportin e progresit mbi zbatimin e vendimeve të marra në kuadër të politikës së përcaktuar nga Samiti Islamik;

- **Sekretari i Përgjithshëm** - i cili zgjidhet nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm për një periudhë pesë vjeçare, me të drejtë për kandidim vetëm njëherë. Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga kombësitë e shteteve anëtare, duke u bazuar në principet e shpërndarjes së barabartë gjeografike, rotacionit dhe mundësisë së barabartë për të gjithë shtetet anëtare, duke i marrë parasysh kriteret e kompetencës, integritetit dhe eksperiencës. Prej vitit 1970 deri në vitin 2017, OBI ka pasur gjithsej 11 Sekretarë të Përgjithshëm, ku i fundit është zgjedhur në vitin 2016, Jusuf bin Ahmed El-Othaimen nga Arabia Saudite. Sekretari i Përgjithshëm merr këto përgjegjësi: u tërheq vëmendjen organeve kompetente të Organizatës, është në shërbim të përmirësimit të objektivave të saj; përcjell zbatimin e vendimeve, rezolutave dhe rekomandimeve të Samitit Islamik, Këshillit të Ministrave të Jashtëm dhe takimet e tjera

¹⁶ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=52&p_ref=26&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

të ministrave; koordinon dhe harmonizon punën e organeve të Organizatës; përgatit programin dhe buxhetin e Sekretariatit të Përgjithshëm; si dhe nxit komunikimin mes shteteve anëtare duke lehtësuar konsultimet dhe shkëmbimin e pikëpamjeve¹⁷;

- **Organizatat ndihmëse** - Qendra e Kërkimit Statistikor, Ekonomik dhe Social, dhe Qendra e Trajnimit të vendeve islame; Qendra hulumtuese për historinë, artin dhe kulturën islame; Universiteti Islamik i Teknologjisë; Qendra islamike për zhvillim të tregtisë; Akademia ndërkombëtare e Fikhut (Jurispudencës Islame); si dhe Fondet Islame për solidarizim dhe Vakëfet;¹⁸

- **Institucionet e specializuara** - Banka Islamike për Zhvillim; Agjencisë Ndërkombëtare Islamike e Lajmeve; Organizata Islamike për Edukim, Shkencë dhe Kulturë; Bashkimi Islamik i Transmetimeve; Komiteti Islamik i Gjysmëhënës Ndërkombëtare; Organizata për shkencë, teknologji dhe inovacion;¹⁹

- **Institucionet e ndërlidhura** - Universiteti Ndërkombëtar Islamik i Malajzisë; Bashkimi Ndërkombëtar i Skuadrave Muslimane, Dhoma Islame e Tregtisë, Industrisë dhe Bujqësisë; Organizata e Kryeqyteteve dhe Qyteteve; Federata Islamike e Sportit të Solidaritetit; Federata Botërore e Shkollave Ndërkombëtare Arabo-Islamike; Konferenca e Forumit të Rinjve për Dialog dhe Bashkëpunim; etj.²⁰

3. Roli dhe rëndësia e OBI-së në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në paqen dhe sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare

Roli dhe rëndësia e OBI-së nuk mund të shihet vetëm se në aspekt të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shteteve anëtare, por edhe në aspekt të sigurisë dhe paqes rajonale, duke nxjerrë në pah herë pas here edhe përkrahjet të cilat jepen nga ana e shteteve anëtare për intervenime të ndryshme ushtarake në vendet konfliktuale të rajonit. Gjithashtu OBI ka luajtur rol edhe në aspekt të reagimit kundër tentativave për të njollosur figurën e profetit Muhamed nëpërmjet karikaturave, kundër etiketimit të Islamit si fe e terrorizmit dhe vrasjeve, si dhe në zgjidhjen e konfliktit disa dekadash mes Palestinës dhe Izraelit. Njëri ndër reagimet që ka bërë OBI, është kritika

¹⁷ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=38&p_ref=14&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

¹⁸ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=64&p_ref=33&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

¹⁹ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=65&p_ref=34&lan=en, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

²⁰ https://www.oic-oci.org/page/?p_id=66&p_ref=35&lan=en, gjetur me datë 4 Nëntor 2017.

ndaj filmit Fitna i realizuar nga politikani holandez Geert Wilders, një film i cili përmbante pamje shqetësuese të dhunës dhe brutalitetit, e në prapaskenë të bashkangjitura versete të Librit të Shenjtë të muslimanëve, Kur'anit. Reagimi i OBI-së, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të periudhës 2004-2014 Ekmeledin Ihnsanoglu ishte si në vijim: *“Filmi ka pasur për tentativë për të njothosur dhe nxirë Kur'anin e Shenjtë, gjë që ka shkaktuar fyerje për ndjenjat e më shumë se 1.3 miliardë muslimanëve në botë. Filmi ishte një veprim i qëllimshëm i diskriminimit, kundër muslimanëve, duke synuar në këtë mënyrë të provojë trazira dhe jo tolerancë.”*²¹ Nëpërmjet kësaj deklarate të përbashkët të OBI-së, filmi në fjalë kritikohet ashpër për vetë faktin që janë lënduar ndjenjat e muslimanëve në mbarë botën dhe që kjo mund të shkaktonte konflikte në Evropë dhe botë. Gjithashtu edhe Bashkimi Evropian dhe Bashkimi i Gazetarëve të Danimarkës ishin kundër këtij filmi, ku ky i fundit paralajmëroi që do të padiste politikanin në fjalë për përdorimin e karikaturës së profetit Muhamed. Në Samitin e shteteve muslimane të mbajtur në Mekë në dhjetor të vitit 2005, vendet anëtare të OBI-së, përfshirë edhe liderët e asaj kohe të Iranit dhe Arabisë Saudite, Mahmud Ahmedinexhad dhe mbretin Abdullah Abdul Aziz, reagues kundër karikaturave debatuese për figurën e Profetit Muhamed, të cilat në shtator të vitit 2005 ishin publikuar në gazetën daneze Jyllands-Posten. Edhe pse drejtuesit e kësaj gazete u arsyetuan që kjo ishte një përpjekje për të kontribuar në debatin për kritikën ndaj islamit dhe vetëcenzurimin, bashkësia muslimane në Danimarkë reagues dhe ngritën zërin, gjë që çoi në protesta në mbarë botën, përfshirë edhe demonstrata të dhunshme dhe trazira në disa vende muslimane. OBI-ja ka luajtur rolin kyç në nxitjen e protestave paqësore dhe demokratike në botën Islame kundër këtyre karikaturave. *“Ne shprehim shqetësimin tonë për urrejtjen e shprehur kundër Islamit dhe muslimanëve dhe jemi kundër tentativës së fundit për përdhosjen e figurës së Profetit Muhamed.”*²² Si rezultat i publikimit të karikaturave nga gazeta e Danimarkës, pasuan protesta dhe marshime kundër këtij publikimi në: Kopenhagë, Londër, Indonezi, Malajzi, kurse nga ana tjetër Arabia Saudite bënte thirrje për bojkot të produkteve daneze dhe u sulmua ambasada e Danimarkës në

²¹ <http://edition.cnn.com/2008/WORLD/europe/03/28/islam.film/index.html>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

²² <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/how-a-meeting-of-leaders-in-mecca-set-off-the-cartoon-wars-around-the-world-6109473.html>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

Teheran. Edhe pse në dukje të parë thirrja e OBI-së duket se ka ngjallur tensione dhe trazira, duke u bazuar në atë që figura e profetit Muhamed ka një vend të rëndësishëm për praktikuesit e fesë islame, roli i organizatës ka qenë për të vendosur ura bashkëpunimi me vendet evropiane, me theks të veçantë Danimarkën, gjë që del në pah me pakënaqësinë ndaj këtij akti, ku ambasadorët e dhjetë vendeve arabe kanë kërkuar takim me kryeministrin danez Fogh Rasmussen, ku ky i fundit ka refuzuar këtë takim duke thënë që qeveria e tij nuk është në gjendje që të përzihet në lirinë e shtypit.²³ Karikaturat të cilat u publikuan nga gazeta daneze në botën perëndimore dhe atë evropiane mund të duken normale dhe tentativa për të ngjallur debatin dhe kritikën, por shikuar nga aspekti i vendeve arabe dhe atyre me shumicë muslimane, ato janë ofenduese. Nëse e drejtë dhe liri themelore në perëndim është që të shprehësh lirinë e mendimit duke u munduar që nëpërmjet një karikature të improvizosh diçka duke u bazuar në rrethanat e kohës dhe sjelljet e muslimanëve në botë dhe jo në të vërteta historike për të kaluarën islame dhe figurën e profetit Muhamed, në botën arabe dhe atë muslimane pikërisht kjo paraqet shkelje dhe përdhosje e të drejtës dhe lirisë së njeriut, pasi që figura e profetit Muhamed është e një rëndësie të veçantë, ku përveç që emrin e këtij profeti e përmendin thirrësit (muezinët) nëpër minaret e xhamive pesë herë në ditë, vendet me shumicë muslimane, gjatë muajit kur ka lindur ai, mbajnë manifestime dhe tribuna fetare për të paraqitur jetën dhe veprimtarinë e tij.

Konflikti izraelito-palestinez është njëri ndër më të stërzgaturat dhe aktualët në Lindjen e Mesme. Qëndrimi i vendeve anëtare të OBI-së është përkrahja e zgjidhjes **dy-shtete**, ku zgjidhja është që të ekzistojë shteti i Palestinës dhe ai i Izraelit, andaj edhe në Samitin e pestë të Jashtëzakonshëm të OBI-së, të mbajtur në mars të vitit 2016, bota islame nëpërmjet “zërit” të OBI-së bëri thirrje për bojkot të produkteve të cilat mbajnë vulën e Izraelit, si një mënyrë për ti bërë presion Izraelit që të mos zgjerojë shtetin në territoret palestineze.²⁴ Paraprakisht, në vitin 2013 gjatë takimit në kryeqytetin e Guinesë, Konakrit, Sekretari Gjeneral i asaj kohe Ekmeleddin Ihnsanoglu, ka theksuar që do të diskutojë me ministrat e jashtëm të shteteve anëtare

²³<http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/how-a-meeting-of-leaders-in-mecca-set-off-the-cartoon-wars-around-the-world-6109473.html>, gjetur me datë 8 Nëntor 2017.

²⁴<http://www.thejakartapost.com/news/2016/03/07/oic-calls-ban-israeli-products.html>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017

për të ndërprerë lidhjet diplomatike me të gjitha vendet që e njohin Jerusalemin si kryeqytetin e Izraelit dhe që transferojnë ambasadat e tyre atje.²⁵ Kjo deklaratë e sekretarit gjeneral të OBI-së, duket që cenon në një farë mënyrë paqen dhe sigurinë e rajonit, duke e pasur parasysh që konflikti izraelito-palestinez është i një ndjeshmërie të lartë dhe që shumë interesa të fuqive të mëdha përplasen pikërisht në këtë vend, por edhe që shikuar në aspektin religjioz, është vendi i cili shihet si vend i shenjtë nga të tre fetë qiellore: judaizmi, krishterimi dhe islami. Vendet anëtare të OBI-së, sidomos ato të Azisë, pranojnë shtetin e Izraelit, por jo me kufijtë e sotëm, pasi që e konsiderojnë si një kolonizim të territoreve të shenjta të Palestinës. Kur jemi tek çështja e konflikteve në Lindjen e Mesme, duhet cekur që në mars të vitit 2015 OBI-ja i dha mbështetje ndërhyrjes ushtarake të udhëhequr nga Arabia Saudite në Jemen kundër komunitetit shia zejdi.²⁶

Siç kemi cekur edhe më lartë, OBI është përpiluese e Deklaratës së Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam dhe që në Nenet 24 dhe 25 të kësaj Deklarate theksohet që *“të gjithë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Deklaratë janë pjesë përbërëse të Sheriatit Islam ... dhe që Sheriati është i vetmi burim reference për shpjegimin apo qartësimin e çdo neni të kësaj Deklarate”*²⁷ Nga këto dy nene të kësaj Deklarate mund të kuptohet që jo çdo liri dhe e drejtë njerëzore e cila është e paraparë me Kartën e të Drejtave të Njeriut sipas OKB-së, është e drejtë dhe liri sipas Deklaratës së Kajros, gjë që ka nxitur kritika nga ana e Këshillit të OKB-së për të drejtat njerëzore dhe grupet muslimane liberale. Sipas Robert Carle, në *“bashkimin e tyre të pakritikuar mes shariatit tradicional dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, formulimet e të drejtave të njeriut artificialisht harmonizojnë dallimet mes dy traditave. Në këtë proces, përmbajtja emancipuese e të drejtave të njeriut kufizohet, në qoftë se nuk anulohet plotësisht.”*²⁸ Kritikët e Deklaratës së Kajros për të Drejtat e Njeriut, nuk janë të mendimit që OBI-ja jep kontribut në mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare, por të bazuara kryesisht në të drejtën

²⁵<https://www.middleeastmonitor.com/20140210-oic-proposes-severing-ties-with-countries-that-recognise-jerusalem-as-israels-capital/>, gjetur me datë 4 Nëntor 2017.

²⁶ <http://www.arabnews.com/saudi-arabia/news/723946>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

²⁷ <http://hrlibrary.umn.edu/instree/cairodeclaration.html>, gjetur me datë 4 Nëntor 2017.

²⁸ Robert Carle, “Revealing and Concealing Islamist Discourse on Human Rights”, Human Rights Review, Prill-Qershor 2005, f. 123, gjetur në https://www.researchgate.net/publication/251746298_Revealing_and_concealing_Islamist_discourse_on_human_rights, në datën 4 Nëntor 2017.

islame. Sipas autorit Will Kymlicka, OBI-ja ka dështuar edhe në diskutimin dhe trajtimin e grupeve etnike minoritare në vendet anëtare të OBI-së, siç janë shtypjet dhe tiranitë ndaj kurdëve në Siri dhe Turqi, banorëve të Ahvazit në Iran, hazarasëve (të përkatësisë shia) në Afganistan, akdhamëve në Jemen, si dhe berberëve në Algjeri.²⁹

Pas rishikimeve të bëra Kartës së OBI-së në vitin 2008, vendet anëtare u pajtuan që të themelonin Komisionin e Përhershëm të Pavarur për të Drejtat e Njeriut (KPPDNJ), një organ këshillimi totalisht i pavarur nga OBI-ja, i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme dhe me përgatitje profesionale adekuate. Roli i këtij organi të pavarur do të ishte që të vëzhgojë të drejtat e njeriut në vendet anëtare të OBI-së, si dhe të lehtësojë integrimin e këtyre të drejtave në të gjitha mandatet e OBI-së. KPPDNJ-ja gjithashtu do të ndihmonte në nxitjen e të drejtave politike, qytetare dhe ekonomike të të gjithë shteteve anëtare. Si duket themelimi i këtij organi të pavarur reflektoi pozitivisht, pasi që në shtator të vitit 2017 ky Komision i OBI-së dënoi ashpër shkeljet e të drejtave të njeriut të muslimanëve të Mianmarit. *“KPPDNJ u bën thirrje të gjithë vendeve anëtare të OBI-së, me theks të veçantë vendeve fqinje, për t’i nxitur Mianmarin të mbështesë detyrimet e saj në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grupit minoritar të rohingas, si dhe të shprehin shqetësimet e tyre në të gjithë forumet e duhura ndërkombëtare, përfshirë këtu Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Këshillin e Sigurimit.”*³⁰

Të drejtat e grupit LGBT, gjithashtu paraqesin një çështje delikate dhe të padëshirueshme në forumet e OBI-së. Në mars të vitit 2012, Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut mbajti diskutimin e parë për diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, pas miratimit të rezolutës për mbështetjen e të drejtave të grupit LGBT të propozuar nga Afrika Jugore. Përfaqësuesi i Pakistanit në këtë Këshilliu drejtua grupit punues në emër të OBI-së, duke denoncuar diskutimin dhe çështjen e pyetjeve për orientimin seksual, pasi që kjo ishte një promovim i sjelljes së shthurur dhe që ishte në kundërshtim me mësimet e religjioneve të ndryshme të botës, përfshirë këtu edhe fenë islame. Si rezultat i këtij fjalimi, pjesa dërmuese e përfaqësuesve të vendeve arabe

²⁹ Will Kymlicka, “Multicultural Odysseys: Navigating the New International Politics of Diversity”, Oxford University Press, New York, 2007, f. 308.

³⁰ <http://www.arabnews.com/node/1155966/saudi-arabia>, gjetur me datë 3 Nëntor 2017.

dhe disa vende afrikane lëshuan diskutimin.³¹ Sa u takon të drejtave të LGBT-së, është për tu theksuar që shtete anëtare të OBI-së, të tilla si: Shqipëria, Gaboni, Sierra Leone dhe Guinea Bisau, kanë nënshkruar Deklaratën e OKB-së për të mbështetur të drejtat e LGBT-së në Asamblenë e Përgjithshme.³² Në vitin 2016, 51 shtete muslimane bllokuan 11 organizata të transgjiorëve dhe homoseksualëve për të marrë pjesë në një takim të nivelit të lartë në OKB, duke nxitur protesta kundër këtij veprimi në SHBA, Kanada dhe Bashkimin Evropian.³³ Përveç çështjes së të drejtave të LGBT-së, një mosmarrëveshje mes OKB-së dhe OBI-së është edhe çështja e konceptit dhe definimit të terrorizmit.

Conclusion

From all this we elaborated in this research paper, we may conclude that the OIC plays a special role in terms of protecting the freedoms and human rights of member countries, although there are many criticisms. Considering that most of the member states are Arabs, the Sunni Islamic group is dominant in this organization, weakening the power and influence of the Iran-led Shi'ite group. OIC has a rich organizational structure, therefore must contribute initially to resolve the conflict between Shia and Sunni groups that appear from time to time in different Muslim countries, to ensure stability, peace, and security in the Middle East. Resolving the Israeli-Palestinian conflict should remain on the agenda of the organization's priorities, with the aim of reducing tensions and riots in this country. The reactions of the OIC on the issue of the cartoons and film, taking into consideration that it represents the rights and freedoms of member countries, are acceptable, since the figure of the Prophet Muhammad is a part of Muslim life. Interestingly, some OIC member states have signed the UN Declaration on the Rights of the LGBT Group, including Albania. Being the only European member state of the OIC and having aspirations being part of the Western and European family, It will be difficult maintaining relations with both sides. OIC needs to be further emphasized in the protection of human rights and freedoms, with particular emphasis on

³¹ <https://af.reuters.com/article/topNews/idAFJJOE82702T20120308?sp=true>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

³² <http://geneva.usmission.gov/2011/03/22/lgbtrights/>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

³³ <https://www.reuters.com/article/us-un-lgbt-aids/muslim-states-block-gay-groups-from-u-n-aids-meeting-u-s-protests-idUSKCN0Y827F>, gjetur me datë 2 Nëntor 2017.

the Muslim world, as peace and stability in the Middle East is a very valuable guarantee of peace and international security.

Materialet e shfrytëzuara

1. Charter of the Organisation of Islamic Cooperation
2. Will Kymlicka, “ Multicultural Odysseys: Navigating the New International Politics of Diversity”, Oxford University Press, New York, 2007
3. Robert Carle, “Revealing and Concealing Islamist Discourse on Human Rights”, Human Rights Review, Prill-Qershor 2005, gjetur në https://www.researchgate.net/publication/251746298_Revealing_and_concealing_Islamist_discourse_on_human_rights
4. https://www.oic-oci.org/page/?p_id=52&p_ref=26&lan=en
5. <http://www.crwflags.com/fotw/flags/int-oic.html>
6. <http://hrlibrary.umn.edu/instree/cairodeclaration.html>
7. <https://www.oic-oci.org/states/?lan=en>
8. <http://www.puic.org/new/index.php/member-states/member-states>
9. <https://web.archive.org/web/20071202125420/http://www.guardian.co.uk/world/latest/story/0%2C%2C-6740455%2C00.html>
10. <https://2009-2017.state.gov/r/pa/ei/biog/237813.htm>
11. <https://www.snopes.com/inboxer/outrage/unvote.asp>
12. <http://edition.cnn.com/2008/WORLD/europe/03/28/islam.file/index.html>
13. <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/how-a-meeting-of-leaders-in-mecca-set-off-the-cartoon-wars-around-the-world-6109473.html>
14. <http://www.thejakartapost.com/news/2016/03/07/oic-calls-ban-israeli-products.html>
15. <https://www.middleeastmonitor.com/20140210-oic-proposes-severing-ties-with-countries-that-recognise-jerusalem-as-israels-capital/>
16. <http://www.arabnews.com/node/1155966/saudi-arabia>
17. <https://af.reuters.com/article/topNews/idAFJOE82702T20120308?sp=true>
18. <http://geneva.usmission.gov/2011/03/22/lgbtrights/>
19. <https://www.reuters.com/article/us-un-lgbt-aids/muslim-states-block-gay-groups-from-u-n-aids-meeting-u-s-protests-idUSKCN0Y827F>